



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PËR SHITJE TE ASETETEVE

SHITJA E MASËS DRUSORE SIPAS PLANIT OPERATIV 2018 NJËSIA MENAXHUESE "MOKNA- NGA STRA 013 – LOT 2 E TENDERIT

Nr. 633 / 018/ 046 / 221-R

Neni 1 Lënda

KJO KONTRATË e lidhur më në mes të: Komuna e Istogut- Drektorati per Bujqësi dhe Hidroekonomi këtu e tutje i referuar me "Autoriteti Kontraktues"), në një rën anë, dhe N T. "CHARY" me NRB 70695812 të cilën e përfaqëson z. Nezir Zeqiraj , (këtu e tutje i referuar si "Blerësi"), në anën tjetër:

NDËRSA Autoriteti Kontraktues ka ftuar tenderët për shitje të aseteve, *si ne Titullin e Kontratës dhe specifikimin teknik te dosjës* dhe ka pranuar Tenderin e dorëzuar nga Blerësi për blerjen e këtyre aseteve.

TANI KJO MARRËVESHTJE DËSHMON SI NË VIJIM:

1. Blerësi pajtohet të paguaj Autoritetin Kontraktues për marrjen e Asetit, Çmimin e Kontratës në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me Kontratë.
2. Duke konsideruar pagesat e kryera nga Blerësi, Autoriteti Kontraktues, siç theksohet në Kontratë, pajtohet të lëshoj Asetet në pajtim me dispozitat e kontratës.
3. Blerësi pagesën do ta kryejë ne pajtim me Udhezimin Administrativ si ne vijim: **40%** avans para nenshkrimit te kontratës, **30%** pas prerjes dhe bartjes se 50% te mases se pergjithshme drusore dhe **30%** pas perfundimit te pranimi te asetit në Xh.LI rrjedhëse Nr. **1000400070001150**
4. Blerësi është i obliguar qe pagesen per parcelat ne fjale t'i bëjë per secilen ngaster veq e veq.

5. Kontrata do të permbushet ne nje afat prej 1 viti, nga data e nenshkrimit të kontratës.

Neni 2 Lokacioni i Aseteve

2.1 Lokacioni i asetëve është: **NJËSIA MENAXHUESE "MOKNA" E SPECIFIKUAR NË LISTËN E ASETËVE DHE PERSHKRIMIN E ÇMIMEVE e datës: 27.07.2018.** *qe është pjesë përbërëse e kontratës:*

2.2 Zyrtari që duhet kontaktuar për aranzhimin e marrjes së asetëve është *(do te jete i caktuar me vendim nga Njësija Kërkuese ose Zyrtari Kryesor Administrativ)*

Neni 3 Çmimi i kontratës

3.1 Çmimi total do të jetë: **50.005,80 €; Pesëdhjetëmijëezerozeropesëe 80/100 Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Blerësi i ka borxh Autoritetit Kontraktues sipas kontratës.

3.3 Çmimi do të jetë përfundimtar dhe nuk do të ndryshohet.

3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme të kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (c) Përshkrimi i Asetëve;
- (d) Tenderi i Blerësit.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5

Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Blerësit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhet me shkrim. Komunikimet do të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [angleze/shqipe/serbe]¹ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Blerësin.

Për Autoritetin Kontraktues:
(shitesin)

Për kontraktorin:
(Blerësin)

Emri:	Lulzim Shoshi	Emri:	Nezir Zeqiraj
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.10/18	Data:	29.10 2018
Vula:		Vula:	